

Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Bursës Studimore dhe Sigurimin Shtesë në Rast të Vdekjes - DL071209

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin e Bursës Studimore dhe Sigurimin Shtesë në Rast të Vdekjes, në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës të cilin Kontraktuesi i Sigurimit e nënshkruan me Siguruesin.
2. Kohëzgjatja e kontraktuar e sigurimit është e ndarë në dy periudha:
 - a. periudha e pagesës së primeve, dhe
 - b. periudha e pagesës së bursës
3. Periudha e pagesës së primeve mund të zgjatë nga 0 deri në 20 vjet, ndërsa periudha e pagesës së bursës është e kufizuar në 5 vjet.
4. Periudha e pagesës të primeve nga 0 vjet mund të bëhet vetëm me pagesë të përnjëhershme të primit

Neni 2

Rasti i Siguruar

1. Në bazë të këtyre Kushteve të Veçanta, kontraktohet pagesa e bursës mujore për pesë vjet, për rastin e vdekjes së Personit të Siguruar gjatë periudhës së pagimit të primit ose mbijetesës së saj. Lartësia e bursës është e pavarur nga vdekja e Personit të Siguruar, kështu që Përfituesi i sigurimit përfiton nivelin e njëjtë të bursës, pavarësisht se cili nga rastet e siguruara ka ndodhur. Në çdo rast (vdekje ose mbijetesë) periudha e pagesës së bursës fillon në fund të periudhës së pagesës së primeve, dhe përfundon me skadimin e sigurimit.
2. Me rastin e konkludimit të sigurimit shtesë në rast vdekje, në bazë të këtyre kushteve kontraktohet sigurimi i Personit të Siguruar në kontratën bazë për Sigurimin e Bursës Studimore, në rast vdekje, gjatë kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.
3. Në bazë të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale, mundësohet lidhja e këtij sigurimi me sigurimin shtesë nga pasojat e aksidenteve personale, për sigurimin e Personit të Siguruar në kontratën bazë për Sigurimin e Bursës Studentore. Ky sigurim shtesë nga pasojat e aksidenteve personale mund të zgjasë vetëm gjatë periudhës së pagesës së primeve.

Neni 3

Pagesa e Primeve

1. Pagesa e primeve bëhet në baza mujore, ose përnjëherë. Primet mund të paguhen edhe në baza tre-mujore, gjysmë-vjetore dhe vjetore, me zbritje.
2. Primi paguhet vetëm gjatë periudhës së pagimit të primit. Me rastin e mbijetesës së periudhës së pagesës së primeve, pushojnë detyrimet e pagesës së primit.
3. Nëse ndodh vdekja e Personit të Siguruar gjatë periudhës së pagesës së primeve, dhe kontrata specifikon pagesën mujore të primeve, primit duhet të paguhet deri në fund të muajit, në të cilën ka ndodhur vdekja. Në qoftë se primi nuk është paguar në atë sasi, pagesa e shumave të siguruara reduktohet për nivelin e primit të papaguar. Me rastin e parapagimit të primit, përtej muajit kur ka ndodhur vdekja, ndryshimi i kthehet Përfituesit së bashku me shumën e siguruar. Nëse vdekja ndodh gjatë periudhës së pagesës së bursës, ajo nuk ndikon në detyrimet e Kontraktuesit apo Siguruesit.
4. Në rast që është kontraktuar pagesa në baza tre-mujore, gjysmë-vjetore dhe vjetore, me rastin e vdekjes, pagesat e primeve nuk kthehen, nëse zbritja është zbatuar për atë formë pagese.
5. Në rast që është kontraktuar pagesa e përnjëhershme, me rastin e vdekjes, pagesat e primeve nuk kthehen, sepse për atë formë pagese aplikohen tarifa të veçanta.
6. Në rast që është kontraktuar Sigurimi Shtesë në rast Vdekje, primit për sigurim shtesë paguhet në mënyrë dhe periudhë të njëjtë, si sigurimi bazë.

Neni 4

Shuma e Siguruar

1. Obligimet e Siguruesit definojnë në kontratën për sigurim si bursë mujore. Pagesa e 60 bursave mujore është kufiri i lartë i obligimeve të Siguruesit.

2. Në qoftë se sigurimi është lidhur me Sigurim Shtesë në Rast Vdekje, obligimi i Siguruesit për Sigurim Shtesë në Rast Vdekje është e barabartë me 60 bursa mujore.

Neni 5

Obligimet e Siguruesit

1. Në rast të vdekjes së Personit të Siguruar, gjatë periudhës së kontraktuar të pagesës së primeve, Përfituesit të specifikuar në policë i paguhen, për çdo muaj, për pesë vite, pas përfundimit të periudhës së kontraktuar të pagesës së primeve:
 - a. 50% e bursës së kontraktuar, nëse vdekja ka ndodhur brenda 6 mujorit të parë të kohëzgjatjes së sigurimit
 - b. Bursa e kontraktuar, nëse vdekja ndodh pas 6 muajsh të përfshirjes në sigurim të personit të siguruar
2. Përfshirje nga paragrafi a. i pikës 1. të këtij neni, në rast të vdekjes në 6 muajt e parë të sigurimit, bursa e kontraktuar paguhet plotësisht, nëse:
 - a. Kontraktimi i sigurimit është bërë me kontroll paraprake mjekësore
 - b. Vdekja ka ndodhur si pasojë e aksidentit, në kuptim të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale
 - c. Vdekja ka ndodhur si pasojë e shtatzënisë apo gjatë lindjes
3. Nëse Personi i Siguruar ka mbijetuar periudhën e kontraktuar të pagesës së primeve, Përfituesit të specifikuar në policë i paguhet bursa e kontraktuar mujore për pesë vite
4. Në të gjitha rastet e cekura në pikat 1., 2., 3., të këtij neni, bursa e parë fillon ditën në vijim pas skadimit të periudhës së kontraktuar të pagesës së primit. Bursa paguhet ditën e parë të punës së muajit, për muajin aktual.
5. Në qoftë se Përfituesi i specifikuar në policë vdes gjatë periudhës së pagesave të bursës, Kontraktuesi, me pëlqimin e Personit të Siguruar mund të caktojë një Përfitues tjetër. Nëse Kontraktuesi ose Personi i Siguruar nuk janë më gjallë, bursa ju takon trashëgimtarëve ligjor të Përfituesit të bursës.
6. Përfituesi ka të drejtë të kërkojë parapagimin e bursës mujore në formën vjetore. Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm para se pagesa e 1-rë, 13-të, 25-të, 37-të, 49-të e bursës të jetë kryer, dhe duhet të njoftojë Siguruesin me shkrim të paktën 15 ditë përpara arritjes së bursës të cekur. Ky njoftim zbatohet deri sa të lajmërohet revokimi i saj për të gjitha pagesat e ardhshme
7. Në rast të pikës 6. shuma e pagesës vjetore është llogaritur si vlera e diskontuar e 12 pagesave mujore. Vlera e diskontuar llogaritet në bazë të kamatës 2.75%.
8. Përfituesi mundet deri 15 ditë para datës së pagesës së bursës së parë të kërkojë shtyrjen e pagesës së bursës, dhe atë në maksimum 12 muaj. Shtyrja e pagesës shtyn gjithë periudhën e pagesës së bursës.
9. Në rast të pikës 8. shuma e bursës rritet me interes 2.75% gjatë periudhës së shtyrë.
10. Në qoftë se në kontratën për Sigurimin e Bursës Studimore është lidhur edhe Sigurimi Shtesë në Rast Vdekje, Përfituesit i paguhet një shumë shtesë e barabartë me shumën e 60 bursave mujore të kontraktuara, ose 50% të shumës, në qoftë se rasti i siguruar ka ndodhur në përputhje me paragrafin a. të pikës 1. të këtij neni
11. Në qoftë se në policën për Sigurimin e Bursës Studimore është lidhur edhe Sigurimi Shtesë në Rast Vdekje, dhe Përfituesi ka kërkuar shtyrjen e pagesave të bursës sipas pikës 8. të këtij neni, kjo shtyrje nuk ndikon në zgjatjen e obligimeve në lidhje me Sigurimin Shtesë në rast Vdekje . Detyrimi i Siguruesit mbaron me përfundimin e kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.
12. Në qoftë se në policën për Sigurimin e Bursës Studimore është i lidhur Sigurimi Shtesë nga Aksidentet Personale, obligimet e Siguruesit dalin nga Kushtet e Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale.

Neni 6

Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimit të Jetës

1. Në kontratat për sigurim të nënshkruara me këto Kushte të Veçanta zbatohen nenet e Kushteve të Përgjithshme.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjëres nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme dhe ndonjëres nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.